



**MESAZHI I MYFTIUT
ME RASTIN
E TRE MUAJVE TË MIRË 1441**



**ËSHTË E HABITSHME
ÇËSHTJA E NJERIUT
MOSMIRËNJOHËS..!**



**IRLANDEZËT NUK E HARROJNË
NDIHMËN OSMANE NË KOHËN
E URISË SË MADHE**

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 18 - Nr. 2 (204), Shkurt, 2020

www.myftinia-shkoder.org



MYFTINIASHKODER1990

JETA E KËSAJ BOTE ËSHTË E SHKURTËR PËR T'U BËRË PALË ME TË KEQEN...

*...për të bërë kompromis në kurriz të fesë
e dinjitetit, për t'i kthyer shpinën thirrjes së
All-llahut të Madhëruar për reklammat fallco
të kujt do tjetër që mundohet të mjegullojë
zemrën dhe dritën e arsyes, teksa e merr
për dore njeriun dhe njerëzimin drejt
skëterrave të padijes, mirazheve të rreme
intelektuale, morale, fetare e politike!*



ËSHTË E HABITSHME ÇËSHTJA E NJERIUT MOSMIRËNJOHËS..!

Është e habitshme çështja e njeriut mosmirënjohës dhe mohues ndaj Zotit! Ai jeton i nënshtruar ndaj egos, i skllavëruar nga epshet!

Puna dhe dija e tij nuk janë gjë tjetër, veçse mjete drejt egos dhe epsheve të tij! Përparimi dhe civilizimi i tij, luftërat dhe armiqësitë e tij, nuk janë gjë tjetër veçse mjete të egos dhe nënshtrim ndaj epsheve!

Është e habitshme çështja e njeriut mosmirënjohës dhe mohues ndaj Zotit! Ai adhuron një zot, që e ka formësuar nga epshet e tij, pasi u frymëzua për të nga armiku i tij! Ai adhuron atë që quhet: interes! Interesi që ngrihet mbi vlerësimin e egos së sëmurë, të trupëzuar në të paktën e kësaj bote, në epshe kapriçoze, në dëshira kafshërore, ku nuk merret për bazë opinioni i mendjes, as nuk konsiderohet vendimi i hyjnore!

Është e habitshme çështja e njeriut mosmirënjohës dhe mohues ndaj Zotit! Ai është i gatshëm të ofrojë mendimin e tij, trupin, pasurinë dhe jetën, si kurban për egon e tij dhe afrim drejt epsheve të tij!

Dhe, kush prej të mençurve, (të pakët janë të mençurit në sojin e mosmirënjohësve dhe mohuesve ndaj Zotit), nuk e sheh se si ky lloj njeriu e hap varrin e tij me thonjtë e tij, në tokën e kësaj jete; me vullnet të lartë, seriozitet dhe vazhdimësi?!

A nuk e sheh këtë soj njeriu, tekta vrapon në vazhdimësi dhe me shumë vrull drejt:

- Garimit në armatim, veçanërisht në mesin e shteteve të mëdha?

Kjo është një garë për të imponuar pushtet, për të pushtuar, për të shtuar pasues, për të qëndruar në maje me çdo mjet dhe në çdo nivel, përveç mjeteve të së vërtetës dhe niveleve të moralit!!

- Zhytjes së vazhdueshme në thellësitë e dëmtimit të trupit, deri në shuarjen e jetës së tij, nëpërmjet konsumimit të alkooleve, marrjes së drogërave, pirjes së gjakut, konsumimit të mishit të derrit, mishit të qenit, pirjes së duhanit etj. Edhe pse shkenca e hershme dhe eksperimentet bashkëkohore, vërtetuan se këto gjëra janë të dëmshme për

organizmin!

- Dhënies plot injorancë drejt imoralitetit dhe homoseksualitetit, që i quajnë marrëdhënie intime! Pa marrë në konsideratë nder e karakter, hallall e haram, derisa të zhyten në sëmundje seksuale të rrezikshme, që e çojnë njeriun drejt vdekjes së sigurtë!

- Sulmeve plot guxim të njeriut ndaj

shkatërrimi të përfshijë këtë soj njeriu dhe të tretet: "Kur duam të shkatërrojmë ndonjë vend (popull), i urdhërojmë parinë e tyre (të jenë në rrugë të drejtë), e ata kundërshtojnë; atëherë zbatohet dënimi i merituar kundër tyre dhe i shkatërrojmë krejtësisht!" - (Kur'ani, El-Isra: 16).

Pra, i urdhërojmë (dhe i udhëzojmë) me bindje dhe afrim drejt All-llahut të Madhëruar, ndërsa ata largohen dhe devijojnë.

Kush e shëron këtë soj njeriu të çuditshëm dhe mosmirënjohës, nga çmenduria e tij? Kush e kthen atë në natyrshmërinë e tij fisnike? Kush ia drejton frenat e epsheve të tij dhe ia udhëzon egon e kapriçot e tij? Kush ia mbron trupin, mendimin, pasurinë dhe veprën e tij?

Kush e mëson se njeriu është vëlla i njeriut, prandaj nuk duhet t'i bëjë padrejtësi

atij, as ta poshtërojë, as ta nënçmojë, as ta vjedhë, as ta vrasë, as të abuzojë me nderin e tij, as ta përdhunojë në fisnikërinë e tij?!

Kush e orienton këtë njeri të hutuar e meskin drejt qëllimit të krijimit të tij dhe urtësisë së prezencës së tij në këtë jetë?

Kush e orienton këtë njeri të hutuar e meskin drejt vërtetësisë së njerzillekut të tij, detyrave të tij në jetë dhe vërtetësisë së lidhjes së tij me sojin e tij njeri?

Kush e shpëton këtë njeri nga vetvetja e tij?


Është feja e All-llahut të Madhëruar, të cilën, Ai e zbriti si udhëzim, mëshirë dhe mesazh fisnikërie për njeriun në të dy jetët e tij! Amanetin e përhapjes së saj ia ngarkoi më të mençurit njeri, më të ndershit njeri, më të plotit njeri, Hz. Muhammedit (a.s.), që është ndriçim e dritë!

Shejh Vehbi Sulejman Gavoçi,
(Medine, Rexheb, 1401 h.)

(Nga parathënia e botimit të pestë të librit: "Gruaja muslimane", botimi i tetë, Damask, 1999).

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Muhamed B. Sytari



ËSHTË E HABITSHME ÇËSHTJA E NJERIUT MOSMIRËNJOHËS DHE MOHUES NDAJ ZOTIT! AI ËSHTË I GATSHËM TË OFROJË MENDIMIN E TIJ, TRUPIN, PASURINË DHE JETËN, SI KURBAN PËR EGON E TIJ DHE AFRIM DREJT EPSHEVE TË TIJ!

vëllasë së tij njeri, të cilin e torturon, e përdhunon, e vret, në një mënyrë barbare, që nuk njihet as në instiktet e ujqërve dhe egërsirave, vetëm e vetëm për interesa banale të kësaj bote..., tekta, bota me njerëzit e saj e kanë një fund...

Them, me shumë keqardhje dhe djegie zemre: Ky njeri mosmirënjohës dhe mohues ndaj Zotit të tij, do të vazhdojë të rrëshqasë në dekadencë, në mendjen dhe mendimin e tij, në dijen dhe veprën e tij, në moralin dhe sjelljen e tij, në mbështetjen e tij ndaj vetvetes, a gruas, që është pjesë e tij, derisa



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Nga xhamia e rikonstruktuar e fshatit Ganjollë, ditën e xhuma, më 21 shkurt 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, dha mesazhin e javës nga minberi i xhumasë, duke u fokusuar tek përshkrimi i xhennetit dhe nxitja që feja islame i bën besimtarëve muslimanë për ta ndërtuar këtë jetë me virtyte e mirësi.

"Një njeri që punon për xhennetin e Zotit të tij, është një njeri i disiplinuar me Zotin e tij! Është njeri i rregullt në marrëdhënie me urdhëresat dhe ndalesat e All-llahut të Madhëruar! Është njeri korrekt me jetën, korrekt

"ISLAMI ERDHI SI BEKIM PËR BOTËN!"

"Një njeri që punon për xhennetin e Zotit të tij, është një njeri i disiplinuar me Zotin e tij! Është njeri i rregullt në marrëdhënie me urdhëresat dhe ndalesat e All-llahut të Madhëruar! Është njeri korrekt me jetën, korrekt me tjetrin, korrekt në familje, korrekt në shoqëri, korrekt në punën e tij, njeri prej të cilit nuk del vetëm se e mira!

me tjetrin, korrekt në familje, korrekt në shoqëri, korrekt në punën e tij, njeri prej të cilit nuk del vetëm se e mira! Njeri i pastër, njeri i ndershëm, njeri i komunikueshëm me të tjerët, njeri bamirës, njeri solidar me ata që kanë nevojë! Pra, cilësitë më të mira që mund të ekzistojnë në këtë botë, janë cilësitë e atyre personave, të cilët në ditën e gjykimit do të meritojnë shpërblimet e mëdha nga Zoti i gjithësisë! E, nëse ne kërkojmë, lexojmë e hulumtojmë për këto cilësi, do t'i gjejmë në Kur'anin Famëlartë, që udhëzon drejt më të mirës! Dhe i cili, në një hark kohor prej 23 vitesh, ndryshoi rrjedhën e një populli të shturur e të devijuar dhe i bëri të ishin: "populli më i mirë i krejt njerëzve"! Më i miri popull i historisë së njerëzimit!

Nga këtu, pyetja që duhet t'i

drejtojmë vetes sot, edhe ne shqiptarët që e kemi përqaftuar Islamin, është: Po të bëjmë një krahasim në mesin e 23 viteve të transformimit të arabëve dhe viteve e dekadave të marrëdhënies tonë me Islamin, a jemi ne në fakt korrekt me Islamin tonë? A e kemi perceptuar dhe kuptuar si duhet këtë Islam, për të na nxjerrë nga errësira në dritë? A e kemi përvetësuar ne këtë Islam për të jetuar si njerëz, që e duan All-llahun në çdo vepër prej veprave të tyre? Apo kemi marrë dhe vazhdojmë të marrim nga Islami ynë vetëm pamjen e jashtme? Dhe, a vlen pamja e jashtme e fesë në jetën e përditshme, për të garantuar mirësinë dhe paqen e zemrës dhe të shpirtit, pastaj me të tjerët?! Këto janë pyetje që duhet t'ia drejtojmë vetes, herë pas here!" – tha ndër të tjera Myftiu.

MESAZHI I MYFTIUT ME RASTIN E TRE MUAJVE TË MIRË 1441

Hyrja e Hanës së re të Muajit Rexheb 1441, shënon një moment reflektimi për secilin prej nesh, duke na ftuar të veprojmë e të punojmë, mbështetur mbi pragun e Thirrjes së besimit e të fesë, dritës dhe bekimeve që na vijnë nga Zoti i gjithësisë, Kur'ani Famëlartë dhe traditat e Hz. Muhammedit (a.s.).

Ky është një moment i mrekullueshëm, ku ftohemi të bëjmë llogaritë e krejt vitit, për të korrigjuar e ndrequr, për të përmirësuar e vendosur mbi shinat e duhura jetën tonë, marrëdhëniet me të tjerët, në kërkim të paqes me Zotin e veten, familjen e farefisn, shoqërinë e atdheun, kombin e ymetin islam!

Ka shumë rëndësi të plotësohem nëpërmjet rrugëve të dashnisë dhe përkushtimit në marrëdhënie me fenë tonë, mësimet dhe shpirtin e teksteve, që na ftojnë drejt realizimit të Njeriut Mëkëmbës; njeriut që jeton e punon me dritën e Zotit, që synon lartësitë, që me dinjitet mbron shenjtëritë e tij, që me krenari dhuron mirësi e vlera me këdo e



kudo, që me drejtësi lufton padrejtësitë e preken e kufijve të patolerueshëm të fesë, jetës, mendjes, nderit e pronës!

Jeta e kësaj bote është e shkurtër

për t'u bërë palë me të keqen, për të bërë kompromis në kurriz të fesë e dinjitetit, për t'i kthyer shpinën thirrjes së All-llahut të Madhëruar për reklamat fallco të kujtdo tjetër që mundohet të mjegullojë zemrën dhe dritën e arsyes, tekta e merr për dore njeriun dhe njerëzimin drejt skëterrave të padijes, mirazheve të rreme intelektuale, morale, fetare e politike!

Fillimi i Tre Muajve të Mirë është një periudhë adhurimi, privimi e përkushtimi, për të dëshmuar me çdo qelizë tonën përkatësinë dhe lidhjen me besimin dhe shpirtin e vlerave të Islamit tonë!

All-llahu i Madhëruar me bekimet e Tij jua lehtësoftë këtë rrugëtim të paqtë dhe i begatoftë për ne këto Muaj të shtrenjtë: Rexheb, Shaban e Ramazan!

Me zemër të mirë e pranim!

Myftiu i Juaj,

Imam Muhamed B. Sytari

Shkodër, më 25 shkurt 2020

1 Rexheb 2020



Dr. Mustafa Mahmud

A ËSHTË FEJA OPIUM?

Pra, jepen mundin tënd së pari, lidhe aty ku duhet, pastaj mbështetu në Zotin.

Feja është rizgjim, kujdes dhe zgjuarsia. Llogari ndaj vetes dhe mbikëqyrje e ndërgjegjes në çdo veprim, në çdo fjalë dhe në çdo mendim. E, kjo nuk është gjendja e atij që e pi opiumin!

Ai që e pi vërtet opiumin është materialisti, i cili e mohon fenë, si largim prej përgjegjësive dhe obligimeve.

Ai e përfytyron se jeta e tij është pasuria, se ai nuk ka për të dhënë llogari dhe se nuk ka ringjallje pas vdekjes.

Ai bën çfarë t'i vijë në mendje. E, kjo është ky njeri kundrejt myslimanit fetar, i cili e konsideron veten e tij përgjegjës deri tek komshiu i shtatë!

Dhe, nëse një individ i popullit të tij është i uritur apo qëllon një kafshë, e qorton veten e tij, se ai nuk e ka kryer detyrën fetare, që ka pasur përgjegjësi.

Nuk është e vërtetë se feja jonë ka dalë nga toka (e ka burimin në tokë), prej rrethanave dhe kërkesave shoqërore, për të qenë armë e një shtrese ndaj një shtrese tjetër dhe vërtetim i pasurisë së pasanikëve dhe i varfërisë së fukarenjve. E kundërta është e vërtetë!

Islami ka ardhur si revolucion ndaj të pasurve, ndaj atyre që i fshehin thesaret dhe shfrytëzuesve zullumqarë.

Ai urdhëroi krejt qartë që pasuria të mos qarkullojë në duart e të pasurve, e monopolizojnë dhe e shkëmbejnë mes njerëzve. Por, të gjithë kanë të drejtë në të: "Ata, të cilët e ruajnë arin dhe argjendin, dhe nuk e shpenzojnë në rrugën e Allahut, ata përgëzojnë me një ndëshkim të dhimbshëm". – (Kur'ani, Et-Teube: 34)

Shpenzimi fillon me zekatin e detyrueshëm, 2.5 % të pasurisë, pastaj rritet kjo vlerë me vullnetarizëm, duke dhënë çfarë ke në xhep dhe çfarë ke në dorë, duke mbajtur për veten tënde, vetëm bukën dhe çfarë ke nevojë.

"Të pyesin, se çfarë të shpenzojnë (të japin)? Thuaj: Tepërcën". – (Kur'ani, El-Bekare: 219)

Tepërcia është ajo, e cila është më tepër, se sa ke nevojë dhe të duhet.

Me këtë gjë, Islami ka bashkuar mes obligimit të detyrueshëm e ligjor dhe mes obligimit vullnetar, që bazohet tek ndërgjegjja.

Kjo është më fisnike për njeriun, se sa t'i merret pasuria me forcë dhe konfiskim. Ai ka arritur të shpenzojë (të japë me vullnetarizëm) deri në 90 % pa asnjë falimentim.

Islami nuk ka ardhur për të vërtetuar zullumin e zullumqarëve, por ka ardhur si revolucion i qartë ndaj çdo zullumqari!

NUK KA GABIM MË TË MADH, SE AI QË THOTË SE FEJA ËSHTË OPIUM, SEPSE FEJA NË REALITET ËSHTË PËRGJEGJËSI, OBLIGIME DHE NDJEKJE ARGUMENTI. AJO NUK ËSHTË LEHTËSIM DHE LIRI PA KUFIE, SI RRJEDHOJË NUK ËSHTË LARGIM PREJ PËRGJEGJËSIVE, AS ËSHTË OPIUM. FEJA JONË ËSHTË PUNË, JO PËRTACI: "DHE, THUAJ: PUNONI, ALLAHU DO TA SHIKOJË PUNËN TUAJ".

Ai ka ardhur shpatë dhe luftë mbi kokat e tiranëve dhe persekutorëve.

Ndërsa, për sa i përket akuzës, të cilën e qarkullojnë materialistët, se feja është prapambetje dhe klasore me argumentin e ajeteve: "Allahu ka dalluar disa prej jush nga disa të tjerë në furnizim (rrizk)". – (Kur'ani, En-Nahl: 71), si dhe: "Dhe, i kemi lartësuar disa nga disa të tjerë me shkallë të ndryshme". – (Kur'ani, Ez-Zuhruf: 32)

Ne përgjigjemi, se këto ajete përputhen me Londrën, Parisin, Berlinin dhe Moskën, aq sa përputhen edhe me Kajron, Damaskun dhe Xhiddin.

Nëse ecim në rrugët e Moskës, do të shohim njerëz që ecin në këmbë, që ecin me biçikleta, të tjerë që ngasin makina Moskovich, ose makina luksos Zimmer.

Ky nuk është, veçse dallim në rrizk,

shkallë dhe gradë ekonomike.

Dallimi mes njerëzve është një realitet esencial.

As komunizmi nuk ka mundur ta zhdukë këtë dallim, madje as edhe ekstremistët materialistë dhe anarhistët nuk kanë thënë për barazi.

Barazia është e pamundur, e si mund të barazohen të pabarabartat?

Njerëzit lindin në momentin e lindjes të pabarabartë në zgjuarsia, fuqi, bukuri dhe dhunti. Lindin në shkallë të ndryshme në çdo gjë.

Më e shumta, në të cilën lakmojnë shkollat ekonomike është barazia në shanse, jo barazia në njerëz.

Çdo njeri të gëzojë shanse të barabarta në arsimit, shëndetësi dhe nivel minimal jetese.

Kjo është e njëjta gjë, për të cilën nxisin edhe fetë.

Ndërsa, zhdukja e shtresave dhe e dallimeve, ajo është vetë zullumi dhe është një gjë, e cila bie në kundërshtim me natyrën.

E tërë natyra ngrihet mbi bazën e dallimit, ndryshimit dhe llojshmërisë në frutat e tokës, në kafshë dhe në njerëz.

Tek pambuku, kemi lloje me kërcell të gjatë dhe kërcell të shkurtër.

Tek kafshët dhe njerëzit shohim se dallimet, shkallët dhe ndryshimet janë më të mëdha.

Ky është ligji i ekzistencës mbarë, dallimi.

Urtësia e këtij ligji është e qartë. Sikur njerëzit të kishin lindur të gjithë me një pamje, me një kallëp dhe në të njëjtën kopje, atëherë madje nuk do të kishte pasur nevojë që të lindin fare. Do të kishte mjaftuar të sillnim një kopje dhe të mos kishim pasur nevojë për të tjerët.

Kështu është gjendja në çdo send dhe kjo do të na kishte çuar në varfërinë e natyrës dhe falimentimin e saj.

Pasuria e natyrës dhe pjelloria e saj nuk duket, vetëm se me shumëllojshmërinë e frutave, rritjen e tyre dhe dallimin në gjyra dhe lloje.

E, megjithatë, feja nuk ka heshtur ndaj dallimeve mes të pasurve dhe të varfërve. Madje ka urdhëruar rregullimin e gjendjes dhe i ka caktuar të varfrit pjesë në pasurinë e të pasurve.

Ajo (feja) ka thënë se ky dallim është fitne dhe sprovë: "Ju kemi bërë sprovë për njëri-tjetrin, a do të duroni". – (Kur'ani, El-Furkan: 20)

Dhe, do të shohim, se çfarë bën i forti me fuqinë e tij. A do të vjedhë, a do të shtypë? Apo do të jetë i butë dhe bamirës?

E, do të shohim, se çfarë bën i varfri me varfërinë e tij. A do të ketë smirë e urrejtje dhe a do të vjedhë e shkatërrojë? Apo do të punojë, do të përpiqet dhe do të derdhë mundë për të ngritur nivelin e tij të jetesës në mënyrë të ligjshme dhe me drejtësi.

Feja ka urdhëruar për drejtësi dhe rregullim të gjendjes përmes shanseve

FEJA NUK KA HESHTUR NDAJ DALLIMEVE MES TË PASURVE DHE TË VARFËRVE. MADJE KA URDHËRUAR RREGULLIMIN E GJENDJES DHE I KA CAKTUAR TË VARFIRIT PJESË NË PASURINË E TË PASURVE. AJO (FEJA) KA THËNË SE KY DALLIM ËSHTË FITNE DHE SPROVË: "JU KEMI BËRË SPROVË PËR NJËRI-TJETRIN, A DO TË DURONI!"

të barabarta dhe ka kërcënuar për ndëshkim në ahiret. Ka thënë se atje do të ketë dallim edhe më të madh, për të rregulluar atë çfarë nuk është rregulluar në tokë: "Dhe, ahireti është me shkallë më të larta dhe me dallime më të mëdha". – (Kur'ani, El-Isra: 21)

Ata, të cilët e akuzojnë Islamin me prapambetje politike, u themi, se Islami ka ardhur me më shumë dispozita përparimtare në sistemin e qeverisjes!

Respektimi i individit në Islam ka arritur kulmin dhe i ka paraprirë kartës së të drejtave të njeriut dhe është superior ndaj saj. Çfarë vlen një individ i vetëm në Islam? Ai vlen sa tërë njerëzimi mbarë! Në Kur'an urdhërohet: "Kush vret një njeri të pafajshëm apo bën shkatërrime në tokë, është sikur të ketë vrarë mbarë njerëzit dhe kush e shpëton atë, është sikur t'i ketë

shpëtuar të gjithë njerëzit!" – (Kur'ani, El-Maide: 32)

Nuk kanë asnjë vlerë arritjet, as reformat materiale, as ndërtimi, as digat dhe as fabrikat, nëse udhëheqësi vret një njeri të vetëm padrejtësisht në rrugën e këtij reformimi, sepse konsiderohet sikur të ketë vrarë mbarë njerëzimin.

Ky është kulmi i respektimit të individit, që nuk e ka arritur asnjë rrymë politike, e vjetër apo e re. Individit në Islam ka vlerë absolute, ndërkohë në të gjitha rrymat politike, ai ka vlerë relative. Individit në Islam është i sigurt në shtëpinë e tij dhe në sekretet e tij: "nuk ka përgjime e as përgojime"; i sigurt në pasurinë, rrizkun, pronat dhe lirinë e tij.

Çdo gjë, deri edhe përshëndetja, lrimi i vendit për t'u ulur ndenjor, edhe fjala e mirë, secila ka vendin e saj në Kur'an.

Kur'ani e ka ndaluar tiraninë, shtypjen dhe pushtetin e individit. Allahu i thotë të Dërguarit (a.s), (e kush është ai në perfeksionimin dhe pozitën e tij): "Ti nuk je i gjithëpushtetshëm ndaj tyre". – (Kur'ani, Kaf: 45), po ashtu: "Ti përkuju, e ti je vetëm përkujuetues, nuk je mbizotëruar ndaj tyre". – (Kur'ani, El-Gashije: 21-22), po ashtu: "Me të vërtetë besimtarët janë vëllezër". – (Kur'ani, El-Huxhurat: 10)

Kur'ani ka ndaluar adhurimin e udhëheqësit dhe hyjnizimin e tij: "Të mos e marrim njëri-tjetrin zotë, përveç Allahut". – (Kur'ani, Ali Imran: 64), si dhe: "Zoti yt ka urdhëruar të mos adhuroni askënd tjetër, përveç Tij". – (Kur'ani, El-Isra: 23)

Ka ndaluar demagogjinë, servilizmin e masave, pasimin dhe ndjekjen e shumicës së humbur, duke thënë: "Por, shumica e njerëzve nuk e dinë". – (Kur'ani, En-Nahl: 38)

"Madje, shumica e tyre nuk mendojnë". – (Kur'ani, El-Ankebut: 63)

Po ashtu thotë: "Shumica e njerëzve nuk besojnë". – (Kur'ani, Hud: 17), si dhe: "Nuk pasojnë, vetëm se dyshimin dhe ata nuk janë, vetëm se gënjeshtarë". – (Kur'ani, Junus: 66)

Dhe: "Ata nuk janë, vetëm se si kafshët, madje ata janë edhe më të humbur". – (Kur'ani, El-Furkan: 44)

Ka ndaluar racizmin dhe fanatizmin: "Më i nderuar nga ju tek Allahu, është ai më i përkushtuari". – (Kur'ani, El-Huxhurat: 13), dhe: "Ai është, i Cili ju krijoi prej një qenieje të vetme". –

(Kur'ani, El-Araf: 189)

Sipas kuptimit shkencor, Islami ka qenë një përbërje dialektike e përgjithshme mes materializmit hebre dhe spiritualizmit të krishterë, mes drejtësisë së thatë e të rreptë, e cila thotë: “Dhëmbi për dhëmbin dhe syri për syrin” dhe mes dashurisë dhe tolerancës ekstreme, e cila thotë: “Kush të qëllon në faqen e djathtë, atëherë ktheja të të qëllonjë edhe në të majtën”.

Kur'ani erdhi i mesëm mes Teuratit, i cili u deformua, derisa u bë libër materialist, që nuk kishte asnjë shkronjë për ahiretin, dhe mes Inxhilit, i cili anoi nga murgëria e plotë. Kur'ani thirri për shpirtin e mëshirës, që bashkonte mes drejtësisë dhe dashurisë, sikurse legjitimoi mbrojtjen e vetes, por ai preferonte ndjesën, tolerancën dhe faljen: “Dhe, për atë që duron dhe falë, me të vërtetë kjo është prej gjërave të mëdha”. – (Kur'ani, Esh-Shura: 43)

Nëse kapitalizmi i dha individit liri të plotë në fitim, deri në shkallën e shfrytëzimit të tjetrit dhe, nëse komunizmi ia konfiskoi plotësisht këtë liri, atëherë Islami paraqiti një zgjidhje të mesme: “Burrave u takon ajo që ato kanë fituar dhe grave u takon ajo që ato kanë fituar”. – (Kur'ani, En-Nisa: 32)

Individi është i lirë të fitojë, por ai nuk ka të drejtë të marrë të tërë frytet e fitimit të tij. Ai, në të, ka një pjesë..., edhe i varfri ka pjesë në të; merret zekati dhe shpenzimi prej 2.5% deri në 90%, me pahir dhe me vullnet. Kjo pjesë nuk është lëmshë (sadaka) dhe mirësi, por është e drejta e Allahut në fitimin e individit. Me këtë ekuacion të bukur, Islami i ka garantuar individit lirinë e tij dhe të varfrit të drejtën e tij.

Prandaj, me këtë, Islami ia ka qëlluar plotësisht, kur i është drejtuar ymetit

islam, duke i thënë: “Kështu, Ne ju kemi bërë ymet i mesëm”. – (Kur'ani, El-Bekare: 143)

Ky nuk është mesatarizëm numerik, por është mesatarizëm dialektik apo i përbërë, i cili bashkon mes dy të kundërtave “të djathtën dhe të majtën”, i tejkalon ato dhe shton përmbi to.

Për këtë arsye në Islam nuk ka “të djathtën” dhe “të majtën”, por ajo është rrugë (sirat) e drejtë e mesme, të cilën ne e quajmë rruga e drejtë (siratul-mustekim), kush del prej saj, djathtas ose majtas, ai ka devijuar.

Kur'ani nuk na ka kushtëzuar me një kushtetutë të veçantë politike të përcaktuar apo metodë të detajuar qeverisjeje, nga dija e Allahut, se rrethanat ndryshojnë sipas kërkesave të interpretimeve në vendosjen e një kushtetute të ndryshueshme në kriza të ndryshueshme. Edhe, që dera të jetë e hapur për myslimanët, në dhënie dhe marrje të eksperiencave të mundshme në çdo kohë, pa u vetëmbyllur brenda një kushtetute.

Prandaj, Kur'ani është mjaftuar me këto porosi politike të përgjithshme paraprake, si specifika të qeverisjes ideale dhe nuk na ka prangosur (lidhur) me një teori përkatëse, e ky është sekret prej sekreteve të mrekullive dhe superioritetit të tij dhe jo varfëri dhe e metë në të!

Kjo është një prekje tjetër e anës përparimtare të Kur'anit, i cili i ka paraprirë tërë përparimeve njerëzore.

U përgjigjemi atyre që thonë, se feja është ndrydhje dhe ngurtësi, se Islami nuk ka qenë kurrë fé e ndrydhjes dhe e ngurtësisë, por ka qenë gjithmonë dhe përherë fé e vizionit, ideve, zhvillimit dhe ndryshimit me argument të ajeteve të qarta: “Thuaj: Udhëtoni nëpër tokë

dhe shikoni si ka filluar krijimi”. – (Kur'ani, El-Ankebut: 20), ose: “Le të shikojë njeriu prej çfarë është krijuar. Është krijuar prej një uji të furishëm, që del përmes kurrizit dhe kraharorit”. – (Kur'ani, Et-Tarik: 5-7), po ashtu: “A, nuk e shikojnë devenë, se si është krijuar? E, qiellin, se si është ngritur? E, malet, se si janë ngulitur? Dhe, tokën, se si është rrafshuar?” – (Kur'ani, El-Gashije: 17-20)

Urdhra të qarta për të vështruar në krijimin e njeriut, në krijimin e kafshëve, në krijimin e maleve, në shtresat e tokës, në qiell dhe në galaktika, në anatomi, në fiziologji, në biologji dhe në shkencën embrionale.

Këto janë urdhra të qarta për të udhëtuar në tokë, për të mbledhur dëshmi, për të nxjerrë dispozita e ligje dhe për të fituar njohuri, se si ka filluar krijimi. E, këto janë ato, që ne i njohim tani si shkencat e evolucionit.

Dhe, nuk ka frikë prej gabimit.

Islami e shpërblen atë, i cili përpiket dhe gabon me një shpërblim dhe atë, të cilin përpiket e ia qëllon, me dy shpërblime!

Nuk është e vërtetë ajo që thuhet, se ne mbetëm prapa me fé dhe perëndimi përparoi me ateizëm. E vërteta është, se ne mbetëm prapa kur braktisëm urdhrat e fesë tonë!

Kur myslimanët zbatonin me të vërtetë këto ajete, aty kishte përparim dhe aty kishte shtet prej oqeanit deri në gjir, si dhe dijetarë të tillë, si: Ibn Sina në mjekësi, Ibn Ruzhdi në filozofi, Ibn Hejthem në matematikë dhe astronomi, Ibn Nefisi në anatomi, Xhabir ibn Hajan në kimi, e shumë të tjerë.

Dynjaja merrte shkencat prej nesh dhe akoma vazhdojnë edhe sot! Galaktikat dhe yjësitë ruajnë emrat

e tyre arabë në fjalorët evropianë. Akoma vazhdojnë ta quajnë aparatit e pikatores në frëngjisht “imbique” dhe prej saj foljen “imbiquer” nga fjala arabe “Embik-امبيق”. Perëndimi nuk ka përparuar me ateizëm, por me shkencë.

Ngatërresa ka ndodhur për shkak të asaj që ka ngjarë në shekujt e mesjetës prej tiranisë së kishës, gjykatave të inkuizicionit dhe ndrydhjes së saj ndaj dijes dhe dijetarëve; me burgosjen që i bëri Galileos dhe djegies së Xhordano Brunos.

Kur kisha devijoi prej qëllimeve fisnike, e së bashku me të edhe papët, ajo ishte element prapambetjeje! Kështu që, kritikët sipërfaqësorë përfytyruan se kjo gjë ka ndodhur edhe me Islamin, e ky është gabim! Sepse, Islami nuk ka papizëm dhe as priftërizëm. Allahu nuk ka vendosur mes Tij dhe mes myslimanëve rrëfyes e as ndërmjetësues!

Atë kohë që Islami sundonte me të vërtetë, ajo ishte koha e përparimit, siç e shpjegojmë dhe siç e thotë edhe historia, duke i përgënjeshtuar të gjitha këto pretendime sipërfaqësore.

Ajetet e Kur'anit janë të qarta në nxitjen e tyre për dije dhe që urdhërojnë për dituri, e as që krijojnë mes dijes dhe fesë asnjë kundërshti: “Dhe, thuaj: Zoti im, ma shto diturinë”. – (Kur'ani, TaHa. 114), ose: “A janë të barabartë ata, të cilët dinë dhe ata, të cilët nuk dinë?” – (Kur'ani, Ez-Zumer: 9), po ashtu: “Allahu dëshmoi, se nuk ka zot tjetër, përveç Tij, edhe melekët dhe njerëzit e ditur (dëshmuar)!” – (Kur'ani, Ali Imran: 18)

Allahu i Madhëruar, në këtë ajet, melekët dhe njerëzit e ditur i ka bashkuar me madhëshatinë e Emrit dhe përkatësisë së Tij.

Ajeti i parë në Kur'an dhe fjala e parë ka qenë “Lexo”, ndërsa dijetarëve në Kur'an i është premtuar grada më e lartë: “Allahu i lartëson ata, të cilët kanë besuar nga ju, ndërsa ata, të cilëve u është dhënë dituria, gradë më të larta”. – (Kur'ani, El-Muxhadele: 11)

Fjala dije dhe fjalëformimet e saj në Kur'an përsëriten rreth 850 herë!

E, si mund të flasë dikush, pas gjithë kësaj, për kundërshtim mes fesë dhe dijes apo ndrydhje të dijes nga feja?!

Vështrimi në fé dhe evoluimi i të kuptuarit të saj është i kërkuar. Tërë historia islame është lëvizje gjallëruese dhe evoluimi. Kur'ani është krejtësisht i pastër (i pafajshëm) prej akuzave të ndrydhjes së njerëzve dhe çdo gjë

në fenë tonë pranon evoluim, përveç thelbit të akides dhe bazës së sheriatit, sepse Allahu është Një dhe nuk evoluon në dy apo tre. Kjo është diçka absolute. Kështu është edhe e keqja, e keqe dhe e mira, e mirë. Kurrë nuk do të bëhet vrasja virtut, as vjedhja bamirësi dhe as gënjeshtria moral i mirë, me të cilin zbukurohen njerëzit e devotshëm!

Përveç këtyre, feja është e hapur për të menduar, për të interpretuar, për të shtuar dhe për të evoluuar. Thelbi i Islamit është arsytim e logjikë që pranon debat, dialog dhe nxit për të përdorur mendjen dhe logjikën.

Më shumë se në një vend dhe më shumë se në një faqe në Kur'an, do të gjejmë pyetje: “A, nuk mendojnë?”, “A, nuk kuptojnë?”.

Njerëzit e fesë tek ne janë: “Ulul-elbab” (njerëz të mendjes).

“Krijesat më të këqija tek Allahu janë të shurdhët dhe të pagojët, ata të cilët nuk kuptojnë!” – (Kur'ani, El-Enfal: 22)

“A, nuk po udhëtojnë nëpër tokë, e të kenë zemra, me të cilat mendojnë apo veshë që dëgjojnë me to.” - (Kur'ani, El-Haxh: 46)

Respektimi i mendjes është në thelb dhe në zemër të fetarizmit.

Dhe, pozitiviteti është nyja dhe revolucioni është shpirtit i fesë.

Islami kurrë nuk ka qenë servilizëm dhe negativitet.

“Dhe, luftoni në rrugën e Allahut, ata cilët ju luftojnë”. – (Kur'ani, El-Bekare: 190)

“Allahu i do ata, të cilët luftojnë në rrugën e Tij, në rreshta, sikur ata të jenë ndërtesë e betonuar fort”. – (Kur'ani, Es-Saf: 4)

Sakrifica me shpirt, me pasuri, me fëmijë dhe lufta, qëndresa, mosbraktisja e betejës, përballja me pesimizmin, përqendrimi dhe lidhja o fortë mes njëri-tjetrit janë në palcë të fesë sonë.

Si mundet një fé me tërë këtë elasticitet, mentalitet, dije, pozitivitet dhe nxitje për zhvillim të akuzohet për ngurtësi dhe ndrydhje, përveç se prej mikut të shtrenjtë doktor, që ka ardhur nga Franca, e që nuk di gjërat parësore të fesë dhe as që ka lexuar një shkronjë nga Kur'ani i tij!?

(Marrë nga libri: DIALOG ME MIKUN TIM ATEIST)

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

NE SHQIPTARËT KEMI NDËRTU SHTETET E TJERA, PO DUHET ME E NDËRTU SHQIPNINË!



“E kisha provuar të vija në Shqipëri në 1974, kur vizitova Kosovën dhe ndjenja atje tre muaj, por kur kërkova të hyja në kufi me Shqipëri nga Prizreni, nuk më lejuan të hyja në vendin tim...por megjithatë unë nuk e mora inat Shqipërinë, pavarësisht se komuniste...”

Do ta kisha vizituar me shumë qejf Shkodrën, ani pse e dija se komunizmi i kishte shkatërruar xhamitë...

Ne shqiptarët jemi njerëz të mirë, shumë të mirë dhe në Siri kemi ndërtuar gjysmën e Sirisë... Ne shqiptarët kemi ndërtu shtetet e tjera, po duhet me e ndërtu Shqipninë mor djema.

Shqipnia asht e bukur dhe e ka fal Zoti (xh.sh) me vende të bukura. Pse me e shkatërro na shqiptarët si në '97?

Jam pikëlluar në 1997 dhe që atëherë s'kam ardh ma në Shqipni, por du me ardh se jam plak e du me e pa për her të fundit Shqipninë dhe Shkodrën...”

Hoxha i jonë, H. Vehbi S. Gavogji (1923 – 2013)

A E KE JETUAR JETËN TËNDE ME FYTYRË TË BARDHË..?

Në suren El-Kijame, urdhëron e thotë: "Atë ditë, ca fytyra do të shndrijnë, teksa vështrojnë Zotin e tyre!". Dhe, pyetja që duhet t'i bëjmë vetes është: Nëse All-llahu i Madhëruar të mundëson ta shohësh Atë në ditën e gjykimit, a e ke merituar këtë mirësi, duke punuar fillimisht në këtë botë, në atë mënyrë që të bën të jesh njeri me fytyrë të bardhë?

Një njeri që punon për xhennetin e Zotit të tij, është një njeri i disiplinuar me Zotin e tij! Është njeri i rregullt në marrëdhënie me urdhëresat dhe ndalesat e All-llahut të Madhëruar! Është njeri korrekt me jetën, korrekt me tjetrin, korrekt në familje, korrekt në shoqëri, korrekt në punën e tij, njeri prej të cilit nuk del vetëm se e mira!

Njeri i pastër, njeri i ndershëm, njeri i komunikueshëm me të tjerët, njeri bamirës, njeri solidar me ata që kanë nevojë! Pra, cilësitë më të mira që mund të ekzistojnë në këtë botë, janë cilësitë e atyre personave, të cilët në ditën e gjykimit do të meritojnë shpërblimet e mëdha nga Zoti i gjithësisë!

E, nëse ne kërkojmë, lexojmë e hulumtojmë për këto cilësi, do t'i gjejmë në Kur'anin Famëllartë, që udhëzon drejt më të mirës! Dhe i cili, në një hark kohor prej 23 vitesh, ndryshoi rrjedhën e një populli të shthurrur e të devijuar dhe i bëri të ishin: "populli më i mirë i kësaj njerëzve"! Më i miri popull i historisë së njerëzimit!

Nga këtu, pyetja që duhet t'i drejtojmë vetes sot, edhe ne shqiptarët që e kemi përçafuar Islamin, është: Po të bëjmë një krahasim në mesin e 23 viteve të transformimit të arabëve dhe, viteve e dekadave të marrëdhënies tonë me Islamin, a jemi ne në fakt korrekt me Islamin tonë?

A e kemi perceptuar dhe kuptuar si duhet këtë Islam, për të na nxjerrë nga errësira në dritë? A e kemi përjetësuar ne këtë Islam për të jetuar si njerëz, që e duan All-llahun në çdo vepër prej veprave të tyre?

Apo kemi marrë dhe vazhdojmë të marrim nga Islami ynë vetëm pamjen e jashtme? Dhe, a vlen pamja e jashtme e fesë në jetën e përditshme, për të garantuar mirësinë dhe paqen e zemrës dhe të shpirtit, pastaj me të tjerët?! Këto janë pyetje që duhet t'ia drejtojmë vetes, herë pas here!

Përpara se të jemi prej banorëve të xhennetit në jetën e përtejme, duhet të punojmë që gjithësecili prej nesh të bëhet element sigurie dhe garant për ta kthyer tokën e tij dhe vendin e tij

në xhennet, ku nuk ka krim, ku nuk ka vrasje, ku nuk ka përgojime, ku nuk ka gjynahe, ku nuk ka thashetheme, ku nuk ka pandershmëri, ku nuk ka korrupsion, ku nuk ka çfarë All-llahu i Madhëruar nuk e don atë dhe, të cilën Pejgamberi (a.s.) e ka ndaluar!

Në suren El-Kijame, urdhëron e thotë: "Atë ditë, ca fytyra do të shndrijnë, teksa vështrojnë Zotin e tyre!". Dhe, pyetja që duhet t'i bëjmë vetes është: Nëse All-llahu i Madhëruar të mundëson ta shohësh Atë në ditën e gjykimit, a e ke merituar këtë mirësi, duke punuar fillimisht në këtë botë, në atë mënyrë që të bën të jesh njeri me fytyrë të bardhë? A e ke jetuar jetën tënde me fytyrë të bardhë, që të vish në ditën e gjykimit me fytyrë të bardhë?

Kjo është sfida, teksa nxisim njëri-tjetrin të distancohemi nga e keqja e t'ia mbyllim asaj derën, teksa i hapim njëkohësisht derën të mirës dhe asaj që vjen nga Zoti i gjithësisë!

(Nga hytbeja e xhumasë, mbajtur nga Imam Muhamed Sytari, në xhaminë e fshatit Ganjollë, më 21 shkurt 2020)



IRLANDEZËT NUK E HARROJNË NDIHMËN OSMANE NË KOHËN E URISË SË MADHE

**AHMET GURHAN KARTAL
HASAN ESEN**

Megjithëse kanë kaluar 173 vjet nga koha kur osmanët ndihmuan popullin e Irlandës në kohën e mungesës më të madhe të ushqimit, populli i këtij vendi ende e përmendin këtë gjest njerëzor dhe bujarinë e osmanëve dhe Sulltan Abdulmexhidit, raporton Anadolu Agency (AA).

Mungesa e ushqimit në Irlandë zgjati nga viti 1845 deri në vitin 1852, kur për shkak të urisë vdiqën një milion banorë të Irlandës, kurse rreth dy milionë të tjerë u detyruan të ikin në vende të tjera.

E njohur edhe si "Uria e Patates", ngjarja u shfaq fillimisht me kalbjen e patateve si pasojë e një vruku.

Pasi dëgjoi lajmet për mungesën e ushqimit me të cilin po përballlej Irlanda, Sulltan Abdulmexhidi mori vendimin për të filluar një aksion humanitar me vlerë deri në 10 mijë funta, e cila nëse llogaritet me vlerën e sotme, është pak më shumë se 1 milion funta ose 1,3 milion dollarë.

Kur Mbretëresha Victoria e Anglisë mësoi për këtë gjest njerëzor, ajo deklaroi se nga kjo shumë mund të pranonte vetëm 2 mijë funta, kurse këshilltarët e saj në Londër refuzonin të praninin ndonjë ofertë që tejkalonte ndihmën e monarkut.

Përballë këtij propozimi befasues, sulltani uli shumën dhe dërgoi 1 mijë funta në Irlandë në vend të 2 mijë.

Megjithatë, Sulltan Abdulmexhidi ishte i gatshëm të ofronte sasi shumë të madhe të parave dhe në fund, në shenjë solidariteti me popullin irlandez, ai dërgoi ndihmë të përbërë nga tri anije plot me ushqime, ilaçe dhe furnizime të tjera.

Meqenëse Marina Britanike nuk lejonte zbarkimin e anijeve të huaja në portet e kryeqytetit Dublin ose Cork, anijet osmane u detyruan të lundronin më tej në veri dhe të zbarkonin ndihmat në portin e Droghedas, një nga qytetet më të vjetra irlandeze, banorët e të cilit nuk harrojnë gjestin human të osmanëve të shekullit XIX.

Levent Murat Burhan, ambasadori i Turqisë në Dublin, në një intervistë për AA tha se populli irlandez nuk ka harruar bujarinë dhe ndihmën e osmanëve, të cilat ata i bënë të paharruara duke

ngritur pllaka përkujtimore dhe në shumë mënyra të tjera.

Kështu, një pllakë përkujtimore u vendos në ndërtesën e Qytetit të Drogheda në vitin 1995 me mbishkrimin "Uria e Madhe në Irlandë e vitit 1847 - në kujtim dhe njohje të bujarisë së popullit të Turqisë ndaj popullit të Irlandës". Kështu, në shenjë mirënjohjeje, në emblemën e qytetit Drogheda u vendos gjysmëhëna osmane.



Në njërën prej rrugëve qendrore të Irlandës është edhe një pllakë në të cilën qytetarët irlandezë falënderojnë popullin osman për veprimin e tyre miqësor dhe solidaritetin.

Në shenjë mirënjohjeje, zyrtarët e atëhershëm të Irlandës i dërguan një letër falënderimi dhe miqësie Sulltan Abdulmexhidit.

Përpos kësaj, Mary McAleese, ish-presidentja e Irlandës, gjatë një vizite në Ankara në vitin 2010, tha se vendi dhe populli i saj nuk do ta harrojnë kurrë bujarinë e osmanëve.

Qytetarët e Irlandës u mahnitën me këtë akt miqësor dhe e vendosën gjysmëhënën osmane në emblemën e Droghed United, klubin e futbollit në vend.

Ka edhe letra të shumta në të cilat irlandezët shprehin falënderimet e tyre ndaj osmanëve për ndihmën e tyre të madhe, kurse ambasadori Burhan i tregoi AA-së një kopje të tillë, në të cilën qëndronte se populli irlandez falënderon osmanët dhe Sulltan Abdulmexhidin për ndihmën e tyre të sinqertë në kohën kur më së shumti kishin nevojë.

Letra theksonte se irlandezët "nuk kishin zgjidhje tjetër përveç që të mbështeteshin në ndihmën dhe dhuratat e vendeve të tjera që ishin prekur më pak", për të shpëtuar veten dhe familjet e tyre nga uria.

"Ju iu përgjigjet thirrjes për ndihmë. Për këtë ndihmë në kohën e duhur dhe bujare e cila ka shpëtuar dhjetëra bashkëqytetarë tanë nga vdekja, ne ju jemi thellësisht mirënjohës", thuhet në letër.

Bujaria e sulltanit osman u vlerësua gjithashtu në një revistë fetare të asaj kohe në tekstin me titull "Sulltani Filantrop".

"Për herë të parë një sundimtar musliman, që përfaqëson një popullsi të madhe islame, ka treguar një dashuri të ngrohtë për popullin e krishterë. Qoftë e pranishme kjo dhembshuri në të gjitha bamirësitë e përbashkëta të njerëzimit dhe të ruhet nga sot midis pasuesve të gjysmëhënës dhe kryqit", thuhet në tekst.

Madje edhe në një revistë nacionaliste irlandeze, sulltani osman ishte përmendur si një "njeri i mirë, i sjellshëm dhe bujar".

Novelisti irlandez James Joyce gjithashtu përmendi ndihmën e Sulltan Abdulmexhidit për irlandezët në romanin "Ulysses", i cili zë një vend të rëndësishëm në historinë e letërsisë.

Ambasadori turk Burhan theksoi se ai kishte vizituar Droghedan disa herë dhe ishte mirëpritur ngrohtësisht çdo herë nga politikanët vendas, duke shtuar se mirënjohja ndaj popullit turk mund të ndjehet në çdo hap.

(www.aa.com.tr)

MBRETËRIA E BAHREJNIT

Bahrejni është një shtet i vogël arab, që gjendet në zonën e Gjirit Arabik.

Sipërfaqja e përgjithshme e Bahrejnit arrin në rreth 760 km². Ky shtet është një ishull në Gjirin Arabik, që laget nga të gjitha anët nga uji. Me Mbretërinë e Arabisë Saudite, Bahrejni lidhet nëpërmjet një ure, që quhet "Ura e Mbretit Fehd". Përtej ujit, nga ana lindore dhe verilindore e Bahrejnit gjendet Republika e Iranit, Arabia Saudite gjendet nga ana perëndimore, veriperëndimore dhe jugore e tij, ndërsa nga ana juglindore e Bahrejnit është Shteti i Katarit.

Bahrejni është një arkipelag që përbëhet nga ishulli i Bahrejnit dhe një numër ishujsh të tjerë më të vegjël.

Popullsia aktuale e Bahrejnit është 1,679,199 banorë.

Kryeqyteti i vendit është Menāme.

KLIMA E BAHREJNIT

Sezoni i verës në Mbretërinë e Bahrejnit karakterizohet nga temperaturat e larta me lagështi të lartë, pasi temperaturat në stinën e verës arrijnë deri në 40 gradë celsius, ndërsa sezoni i dimrit është më i freskët, ku temperaturat mesatare në dimër mund të zbesin deri në 10 gradë celcius, gjatë natës.

GJUHA

Arabishtja është gjuha zyrtare në vend; gjuha angleze përdoret gjithashtu gjerësisht, pasi është e detyrueshme në shkollë, siç ka edhe gjuhë të tjera që fliten nga mërgimtarët, si gjuhët: Urdu, Hindu, etj.

FEJA

Islami është feja zyrtare në Bahrejni. Muslimanët përbëjnë pjesën dërrmuese të popullsisë totale të vendit (70%), pastaj vijnë të krishterët (15%), dhe pjesa e mbetur përbëhet nga pakicat e tjera fetare si hebrenjtë, hindusët dhe bahaitë.

EKONOMIA

Ekonomia e Bahrejnit varet më së shumti nga nafta dhe gazi. Monedha e Bahrejnit zë vendin e dytë në botë për nga vlera. Në vitin 2008, Bahrejni u quajt si qendra financiare me rritjen më të shpejtë në botë. Prodhimi i naftës është produkti më i eksportuar nga Bahrejni,

dhe përbën 60% të fitimeve, 70% të të ardhurave të qeverisë, dhe 11% të GDP-së.

BAHREJNI NË KOHËT E LASHTA

Vendi që quhet Bahrejni sot, përfshin vetëm një pjesë të asaj zone që quhej Bahrejni dikur.

Bahrejni i dikurshëm përfshinte brenda territoreve të tij zonat Eval, Ahsa, El-Katif, si dhe bregdetin që nga Omani, e nga ishulli Kajs që gjendet në brigjet e Iranit, e deri në Basra të Irakut.



Historianët citojnë se historia e Bahrejnit daton që nga periudha e Dilmunit, një qytetërim që u zhvillua tre mijë vjet p.e.s, domethënë, sot e pesë mijë vjet më parë. Dilmun ka qenë njëri prej civilizimeve shumë të vjetra, të njohura nga njeriu, përkrah qytetërimit Sumerian në Mesopotami, dhe atij faraonik në Egjiptin e lashtë... Dilmun, në gjuhën e lashtë sumeriane do të thotë: Përjetësi.

Më vonë, në shekullin e parë të erës sonë, Bahrejni hyri nën sundimin e grekëve, të cilët patën ardhur atje nën komandën e Aleksandrit të Madh, në zbulim të vendeve të reja. Ata e pushtuan Bahrejnin dhe e quajtën Tylos (Tajlos), dhe asokohe ky vend ishte kryeqendra e tregtisë së perlave.

Në shekullin e katërt (e.j), Bahrejni iu bashkua perandorisë sasanide (që më pas u njoh si perandoria Persiane).

ARABËT DHE BAHREJNI

Me shembjen e përsëritur të Digës së Me'ribit në Jemen, aty rreth vitit 1200 (p.e.s), arabët filluan të migronin në drejtim të zonave të Bahrejnit, në kërkim të tokave të reja për banim. Shekuj më vonë, në këto zona që njiheshin si "Toka e Përjetësisë", zunë vend tri fiset e para arabe: Fisi Abdul-Kajs ibn Rabîā, disa barqe nga fisi Bekr Ibn Uāil dhe të tjerë nga fisi Tejm ibn Murrah.

Në kohën kur në Gadishullin Arabik

u shfaq Islami, Bahrejni sundohej nga El-Mundhir ibn Savi, një person i vënë në atë post me autorizim nga persianët.

Fisi Abdul Kajs ishte një nga fiset më të mëdha që ishin vendosur në Bahrejni dhe shumica e prijësve që e sunduan Bahrejnin e Madh, i përkisnin këtij fisi. Ishulli Kajs gjendet akoma dhe sot në Bahrejni, emri i të cilit rrjedh pikërisht nga fisi Abdul-Kajs.

EPOKA ISLAME

Në kohën kur në këtë botë filloi të shfaqej feja Islame, në shekullin e gjashtë (e.j), zona që njihet si Bahrejni, shtrihej që nga Basra e deri në ngushticën e Hormuzit.

Me përhapjen dhe zgjerimin e fesë islame, i Dërguari i Allahut, Muhamedi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), dërgoi në Bahrejni njerin nga shokët e tij, El-Alā ibn El-Hadramij (në vitin 629 e.j; viti i shtatë i Hixhretit), i cili i ftoi banorët e atij rajoni të hynin në Islam.[3]

Sahabiu El-Alā ibn El-Hadramij pati sukses në misionin e tij dhe kështu Bahrejni hyri në Islam në mënyrë paqësore, pa luftë. Më pas, njerëzit e Bahrejnit luajtën një rol të rëndësishëm për zgjerimet Islame, duke i ndihmuar ushtritë muslimane me aftësitë dhe mjeshtëritë që ata zotëronin për lundrim dhe në ekspeditat detare.

Që nga shekulli i tretë hixhrij, e më pas, Bahrejni përjetoj një numër pushtimesh të njëpasnjëshme. Aty erdhën dhe sunduan me radhë Karamitët (deri në vitin 976 e.j), pastaj erdhën Mongolët... pastaj në vitin 1521 erdhën portugezët që qëndruan deri në vitin 1602 dhe pas tyre, Bahrejni hyri nën sundimin e persianëve, të cilët edhe pasi u larguan prej aty, në vazhdimësi kërkonin të ushtronin ndikimin e tyre në vend.

Në vitin 1861, Emiri i Bahrejnit nënshkroi një marrëveshje me Britaninë e Madhe, sipas së cilës Bahrejni hynte nën mbrojtjen e Britanisë. Këtë marrëveshje e rinovoi sërisht në vitin 1880, pastaj dhe në vitin 1892.

Në gushtin e vitit 1971, Bahrejni u shpall i pavarur nga Britania dhe Sheik Isa ibn Selmān e ndryshoi titullin e që mbante, nga "Sundimtari i Bahrejnit", në "Princi i Bahrejnit".

Që nga ajo kohë, Bahrejni është anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe i

Lidhjes Arabe.

Në vitet në vijim, Bahrejni miratoi ratifikimin e Kushtetutës (6 dhjetor, 1973), si dhe formoi Asamblenë Kombëtare (Dhjetor, 1973).

Në vitin 1999, Sheik Isa ibn Selmān, vdiq dhe vendin e tij e zuri djali i tij dhe Princi i Kurorës, Sheik Hamd ibn Isa. Nën drejtimin e këtij të fundit, vendi po dëshmon ndryshime të rëndësishme, drejt demokracisë dhe hapjes politike.[4]

SI ERDHI ISLAMI NË BAHREJN

Sipas Ibn Haxher, fisi Abdul-Kajs, që banonin në Bahrejni në kohën kur u shfaq Islami, kishin krijuar lidhje me të Dërguarin e Allahut (a.s), pikërisht në vitin që ai do të migronte në Medine.

El-Mundhir ibn Ajidh El-Abdi, një burrë nga Bahrejni, kishte dëgjuar për Profetin (a.s), prandaj ai e kishte dërguar djalin e motrës së tij në Mekë, me qëllim që të takohej me të Dërguarin e Allahut dhe të sigurohej se ai vërtetë ishte një Profet i Zotit. Ky person, pasi ishte takuar me Profetin (a.s), e kishte pranuar fenë Islame dhe ishte kthyer si musliman në Bahrejni. El-Mundhir ibn Ajidh El-Abdi, pasi dëgjoj çfarë kishte mësuar nipi i tij, e pranoi edhe ky fenë islame dhe të dy këta e mbajtën të fshehtë konvertimin e tyre në Islam.

Më vonë, në vitin e shtatë të Hixhretit, i Dërguari i Allahut (a.s), e dërgoi sahabiun, El-Alā ibn El-Hadramij me një mesazh të shkruar, për tek El-Mundhir ibn Savi, i cili ishte sundimtar i autorizuar nga persianët në Bahrejni, asokohe.

El-Alā ibn El-Hadramij ia dorëzoi El-Mundhir ibn Savi-t letrën e Profetit (a.s).

Në letër shkruhej:

"Bismilāhi-Rrahmāni-Rrahīm

Nga Muhamedi, i Dërguari i Allahut, tek El Mundhir ibn Savi

Paqja qoftë mbi atë që ndjek udhëzimin!

Kështu, unë të ftoj në Islam. Bëhu musliman, që të jesh i shpëtuar dhe që Allahu ta vërë nën shërbimin tënd gjithë çfarë e ke tani nën sundimin tënd... Dhe dije se feja ime do të mbizotërojë deri në skajet ku mbërrijnë deveja dhe kali."

Sipas burimeve historike, thuhet se El-Mundhir hezitoi ta pranonte kërkesën e të Dërguarit të Allahut.

Më pas, sahabiu El-Alā, i kishte thënë: "O Mundhir, ju jeni një njeri me mendje të shkëlqyer për çështjet e kësaj bote, prandaj, mos lejo që mendja jote të tregohet e vogël në lidhje me çështjet

e botës tjetër! Feja zjarrputiste është një fe e keqe, e cila nuk u bën nderim arabëve dhe as nuk i respekton popujt e Librit (hebrejtë dhe të krishterët)... Ti s'je një njeri që nuk di të logjikojë, prandaj, ki kujdes dhe mos bëj gabimin të mos e besosh të sinqertin, e të mos i besosh besnikut

dhe atij që e mban fjalën! E nëse ekziston ndonjë person me këto cilësi, ai është ky Profet!"

El-Mundhir ishte menduar dhe kishte deklaruar hyrjen e tij në Islam.

Për këtë, ai kishte thënë: "Unë pashë pushtetin që kam në dorë dhe kuptova se ky pushtet i përket vetëm jetës së kësaj bote. Pastaj vërejtja fenë tuaj dhe kuptova se ajo premtonte këtë botë edhe botën tjetër. Çfarë më ndalon mua të pranoj një fe që premtonte të mirat e jetës dhe rehatinë e vdekjes?!"

Kështu ai u bë musliman dhe ua ofroi edhe të tjerëve të pranorin Islamit. Pati nga ata që e pranuan fenë Islame, por dhe nga ata që parapëlqyen të qëndrojnë në fenë e tyre.

El-Mundhir, i ishte përgjigjur të Dërguarit të Allahut (a.s) me një letër, ku shkruante: "O i Dërguari i Zotit, unë e kam lexuar letrën tuaj përpara njerëzve të Bahrejnit dhe pati prej atyre që e pëlqyen Islamit dhe hynë në të, por pati edhe nga ata që nuk u pëlqeu kjo gjë. Në tokën time gjenden zjarrputistë dhe hebrenj, prandaj më thuaj se çfarë të bëj!"

I Dërguari i Allahut (a.s) i qe përgjigjur: **"Me emrin e Zotit, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit**

Nga Muhamedi, i Dërguari i Zotit tek El-Mundhir ibn Savi:

Paqja qoftë mbi ju! Unë së pari lavdëroj Allahun, i Cili nuk ka zot tjetër përveç Tij dhe dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob i Dërguari i Tij.

Pastaj: Unë të kujtoj Zotin e Plotfuqishëm dhe të kujtoj se ai që këshillon për mirë, e bën për veten e tij dhe kush u bindet të dërguarve të mi dhe ndjek urdhrin e tyre, më është bindur mua... e kush i ndihmon ata, më ka ndihmuar mua. Të dërguarit e mi kanë thënë fjalë të mira për ty. Unë po ndërmjetësoj tek ti për popullin tënd, prandaj, lërua muslimanëve pasurinë e tyre, dhe tregoj se u janë falur gjynahet



Mename

e mëparshme, e pranoje hyrjen e tyre në Islam. Cilado qoftë aftësia jote, ne nuk do të të largojmë nga detyra që ke. Dhe kushdo që mban fenë e tij, hebraike ose zjarrputiste, ai duhet të paguajë xhizjen."

Një nga letrat e të Dërguarit të Allahut, drejtuar El-Mundhir ibn Savi-t

Në vitin pasardhës, me urdhër të të Dërguarit të Allahut, në Medine erdhi një delegacion që përbëhej nga personalitete të njohura të zonës që historikisht njihet si Bahrejni.

Që përpara se ata të vinin, i Dërguari i Allahut kishte thënë: "Do të vijnë nga Lindja një delegacion që e kanë pranuar Islamit me dëshirën e tyre, pa i detyruar askush." ... Dhe kur ata mbërritën, Profeti, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, u tha: "Mirë se vini o njerëz, të pa turpëruar dhe të papenduar."...Pastaj bëri këtë lutje: "O Zot, fali gjynahet e fisit Abdul-Kajs!"

Marrëdhënia e Bahrejnit me Islamit është e vjetër. Ky vend ka qenë rajoni i dytë që ka hyrë në Islam, në mënyrë paqësore, pas Medinës së Ndritur. Xhamia Xhuvathe, e ndërtuar në Haxher (El-Ahsa), në rajonin e Bahrejnit të dikurshëm, është xhamia e dytë në të cilën është falur namazi i xhumasë, pas xhamisë së Profetit (a.s) në Medinë [6] dhe muret e asaj xhamie të vjetër janë të dukshme edhe sot.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

• <https://www.worldometers.info/world-population/bahrain-population>

• <https://www.worldometers.info/world-population/bahrain-population/>

• <https://almoheet.net>

• <https://www.aljazeera.net>

• <http://alwaha.com/?act=artc&id=66>

• Bahariu

MYFTIU: "ASNJË TOLERANCË NË ÇËSHTJET E VAKËFIT!"

Në një analizë mbi zhvillimin e vakëfit dhe ecurinë e administrimit të Qendrës Tregtare, Tregun e madh dhe pjesën e liruar në Zdralej, zhvilluar ditën e martë, më 4 shkurt 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, kërkoi nga administrata e Myftinisë Shkodër përkushtim maksimal dhe zero tolerancë në raport me çështjet e vakëfit!

Myftiu theksoi se kur bëhet fjalë për zhvillimin e vakëfit, të gjithë duhet të jemi shërbëtorë dhe ta konsiderojmë çdo pëllëmbë vakëfi si amanet të shtrenjtë e të shenjtë, për të cilin do të japim llogari para duarve të All-llahut!

"Kush dëshiron të punojë me përgjegjësi, duhet ta dëshmojë me vepra konkrete, jo me fjalë! Kur bëhet fjalë për vakëfin, do të thotë se jemi para një amaneti të shenjtë, që tejkalon kufijtë e frikës, ato të lidhjeve familjare, interesit



personal e atij të miqësive! Vakëfi është kufi i ndaluar, para të cilit nuk i mbajmë periz askujt në botë, as përulemi para presioneve, thashethemeve, persekutimit e nëpërkëmbjes!", tha ndër të tjera Myftiu.

Gjatë kësaj analize, administratori dhe menaxheri vunë në dukje ecurinë e deritanishme të zhvillimit të vakëfit në Zdralej, si dhe praktikën që po ndiqet për vënien më efçencë të pjesëve të pazhvilluara a të keqmenaxhuara deri më sot.

AKTIVITET ARGËTUES MË NXËNËSIT E XHAMISË MES-MYSELIM

Më 7 shkurt 2020, sektori i arsimit pranë Myftinisë Shkodër në kuadër të plan-programit për vitin 2020 zhvilloi në ambientet e kompleksit të lojërave "Blu sky" një aktivitet argëtues më nxënësit e kursit fetar të xhamisë Mes-Myselim.

Krahas shumë nxënësve që mësojnë rregullisht në mejtepin e mësim-besimit, merrnin pjesë imami dhe mësuesi i xhamisë, z. Fatmir Sula si dhe drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni.

Fillimisht, teologu Halluni i uroi mirë se ardhjen fëmijëve kursantë në këtë veprimtari argëtuese si dhe gjatë një bisedë të shkurtër u dha disa këshilla fetare dhe edukative të dobishme për ta në çdo etapë të jetës.



MYFTIU I SHKODRËS I FTUAR NË EMISIONIN "AUTOCHTHONOUS", NË TV ROZAFI

Mbrëmjen e së martës, më 11 shkurt 2020, Imam Muhamed B. Sytari, Myftiu i Zonës Shkodër, ishte i ftuar i gazetarit Simon Shkrelu në emisionin "Autochthonous" në Tv Rozafa.



Gjatë një bashkëbisedimi të gjatë, që u realizua në ambientet e xhamisë së Medresesë, Myftiu i Shkodrës u ndal fillimisht në çështjen e besimit dhe të lirisë, duke marrë shkas nga viti jubilar 2020, që përkon me 30-të vjetorin e rikthimit të shpresës dhe lirisë së besimit në vendin tonë dhe zhvillimit të ceremonive të para masive fetare, të cilat kulmuan me faljen e namazit të xhumasë së madhe, më 16 nëntor 1990.

Myftiu theksoi se fryma e besimit dhe e virtyteve të tij, është ajo që duhet të bashkëpunojmë të gjithë së bashku sot, për ta përhapur me sa të

kemi mundësi, në mënyrë që lajmet e frikshme të përhapjes së krimit, drogës, shtimit të aborteve, përhapjes në masë të dhënies së borxheve me fajde, etj., të mos kthehen në lajme të përditshme që e bëjnë të zymtë jetën në vendin tonë.

Myftiu theksoi se duke u kapur si duhet pas fesë dhe moralit të saj, natyrshëm që edhe e keqja me krejt tentakulat e saj do të zvogëlohet e do të zhduket nga realitetet e vendit e mbarë njerëzimit.

Myftiu i Shkodrës foli edhe për dinjitetin njerëzor dhe përhapjen e moralit të fesë jashtë xhamisë, për vakëfet e shumta dhe rrugëtimin e gjatë të këtyre tre dekadave, ku janë bërë përpjekje të shumta për të kthyer në identitet atë që është e Myftinisë Shkodër prej pronave të shumta.

Ai tha se tani, bota islame po përjeton një moment të rrizgjimit të elitave myslimane në botë, që do të thotë se ekuilibrat e botës po ndryshojnë, duke shkuar drejt shërimit nga padrejtësitë, luftërat, shkelja e të drejtave të njeriut, etj.

Në fund, Myftiu tha se është moment, kur njerëzit me vullnet të mirë dhe besimtarë të zgjasin duart e tyre për t'u lidhur me njëra-tjetrën, në mënyrë që të ruhet zinxhiri i vlerave dhe moralit të besimit në realitetet tona shqiptare dhe njerëzore.

MYFTIU TAKOI IMAMËT NË PRAG TË TRE MUAJVE TË MIRË




Paraditën e së enjtes, më 20 shkurt 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, takoi imamët e Myftinisë Shkodër, me të cilët diskutoi mbi aktivitetin në prag të Tre Muajve të Mirë, ecurinë e jetës fetare në Shkodër, në atmosferën e 30 vjetorit të rileyjmit të fesë me ligj, përhapjes së mesazheve islame në mesin e besimtarëve, etj.

Fillimisht, Myftiu përshëndeti përpjekjet dhe sakrificat e imamëve të nderuar për të mbajtur me përgjegjësi e dinjitet amanetin e Thirrjes Islame në Shkodër, duke përhapur ditë pas dite mesazhet e besimit, shpresës dhe duke u bërë nxitës të rrizgjimit të muslimanëve në këtë vend.

Gjatë këtij takimi u dhanë udhëzime që lidhen me gjallërinë e jetës fetare,

"DIALOG ME MIKUN TIM ATEIST", LIBRI MË I RI NË DUART E LEXUESIT

Ditën e hënë, më 17 shkurt 2020, doli në qarkullim libri me titull: "Dialog me mikun tim ateist", nga studiuesi dhe intelektual i shquar egjiptian, Dr. Mustafa Mahmud, përkthyer nga arabishtja nga teologu Lavdrim Hamja.



Libri në fjalë trajton një sërë tematikash, rreth së cilave, shumë njerëz kanë dilema në raportet e tyre me besimin, fenë e fetarizmin, me botëkuptimin islam, Kur'anin Fa m e l a r t e , dërgesën e Hz. Muhammedit (a.s.), si dhe shumë çështje që lidhen me legjislacionin islam, pozitën e gruas, lirinë, shkencat, etj.

Një vepër, që vjen në atmosferën e 30 vjetorit të rileyjimit të fesë me ligj në Shqipëri, në një moment, kur shoqëria shqiptare përballet me dilema të shumta që lidhen me identitetin, fenë, lirinë, demokracinë, shpresën dhe të ardhmen e familjes dhe kombit.


Falënderojmë telogun Lavdrim Hamja për këtë shërbim të vyer dhe lutemi që ky kontribut i tij të ketë sa më shumë lexues dhe të nxisë një debat ndërtues rreth fesë islame, madhështisë dhe alternativës islame, si shpresë për të sotmen dhe të ardhmen e njerëzimit.

sidomos në prag të Tre Muajve të Mirë, për të cilët Myftiu kërkoi që ligjërimet e kësaj periudhe të përqendrohen tek nevoja e pendimit të sinqertë, përgatitjes për Muajin Ramazan, kthimit nga Kur'ani dhe udhëzimet e tij, forcimi i lidhjeve familjare, edukimi i rinisë, përhapja e shpresës dhe e frymës së harmonisë në mesin e muslimanëve.

U diskutua edhe për aktivitetet arsimore, kulturore dhe ato që lidhen me sektorin e rinisë. Poashtu, u dhanë udhëzimet e duhura që kanë të bëjnë me abonimet vjetore në shtypin islam, si dhe u pasqyrua aktiviteti që lidhet me ndërtimin e xhamive të reja dhe rikonstruksioni i xhamive që kanë nevojë për ndërhyrje.

PROF. DR. MUHAMMED AMARA

8 dhjetor 1931 - 28 shkurt 2020
(RAHMET PASTË)



"Filozofia islame është shumë e fortë në argumentimet e saj! Nuk njoh filozofi, që ka arritur të bashkojë mendjen dhe shpirtin, si ajo!"

XHAMIA GANJOLLË, DITË GËZIMI PËR BESIMTARËT E ZONËS



Ditën e xhuma, më 21 shkurt 2020, në një atmosferë të begatë besimi e vëllazërie islame, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Shoqatën "Komiteti i Bashkuar Kuvajtian për Bamirësi"

dhe Shoqatën "Duart e Bamirësisë", organizoi ceremoninë e përirimit të rikonstruksionit të plotë të xhamisë së fshatit Ganjollë, në Njësinë Administrative Guri i Zi.



MEJTEPI I IM... XHAMIA KOSMAÇ

PAK HISTORI:

- Xhamia Kosmaç ndodhet në Njësinë Administrative Bushat, zona Shkodër.

- Përbëhet prej rreth 350 familje myslimane. Fiset më të mëdha të fshatit Kosmaç janë: Haxhajt, Elezët, Gërbetësit, Ballkuqet, Salihajt, Mahmutaliajt, etj.

- Xhamia e re në Kosmaç ka filluar funksionin e saj në vitin 1998, e cila është ndërtuar me ndihmën e shoqatave islame si dhe me ndërmjetësimin e Shejkh H. Vehbi Sulejman Gavoçit.

- Përpara ndërtimit të xhamisë së re, rreth viteve 1992-1998 ritet fetare dhe falja e xhumasë janë kryer në faltoren e vjetër të lagjes Gavoç, ku kanë shërbyer vullnetarisht si imam: Mulla Halil Rama



frekuentojnë kurset-mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi të shtunën më 1 shkurt 2020 takimin e radhës me nxënësit e kursit fetarë të xhamisë Kosmaç.

Në fillim, përgjegjësi i arsimit u mbajti një bisedë rreth rëndësisë dhe vlerës që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin te brezi i ri, për të përçarur te ata mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit (xh.sh).

Më pas, përgjegjësi i arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi Bujar Haxhani si dhe mësuesja Naime Daija.

Gjatë këtij aktiviteti u zhvillua edhe një bashkëbisedim me nxënësit në lidhje me njohuritë fetare e edukative që ata marrin gjatë kursit të mësim-besimit.

dhe Haxhi Adem Sulejmani.

- Në xhaminë e re nga viti 1998 e deri më sot kanë shërbyer si mësues të mejtepeve Osman Kashkir, Ibrahim Sehitaj dhe mësuesi e imami aktual, Bujar Haxhani.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 17 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami, në periudha të ndryshme nga viti 2002 - 2020 është rreth 275 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në vazhdim të vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që





I DËRGUARI I ALL-LLAHUT (A.S)
KA THËNË:

*“Më i miri
i shoqërisë tek
All-llahu
është më i miri
i tyre për
shokun e tij.
Më i miri i
kamshive tek
All-llahu
është më i miri
i tyre për
kamshiun e tij!”*

(Transmetuar nga Imam Ahmedî,
Tirmidhiu dhe Hakimi)

LAJMI I GËZUAR PËR FAMILJEN E Z. LULZIM CURRI NË DRISHT

Ditën e enjte paradite, më datë 26 shkurt 2020, Myftinia Shkodër me mbështetjen e emigrantëve nga fshatit Drisht, por jo vetëm dhe në koordinim me administratorin e Njesisë Administrative Postribë, Bashkia Shkodër, z. Altin Shabaj, inspektuan familjen e z. Lulzim Curri dhe i dhanë lajmin e mirë dhe të gëzueshëm për fillimin e restaurimit të banesës së tij, duke e kthyer në kushte të përshtatshme dhe duhura për banim.

Banesa në fjalë, ku jeton kjo familje, është në kushte të papërshtatshme dhe jashtë çdo parametri për të banuar në të.

Thirrjes për sensibilizim i janë përgjigjur pozitivisht emigrantët e fshatit Drisht, por edhe të zonës së Postribës dhe të tjerë, të cilët kanë arritur të mbledhin një fond për rikonstruksionin e banesës së familjes Curri dhe kthimin e saj në një ambient të banueshëm dhe me kushte të përshtatshme për të jetuar.

Në emër të Myftinisë Shkodër u prononcua teologu Arben Halluni, i cili ndër të tjera tha: Sot po japim një lajm të gëzueshëm për këtë familje, sepse po përurojmë fillimin e punimeve për restaurimin e shtëpisë së Lulzimit. Kjo iniciativë e mirë përkon me fillimin e tre muajve të mirë, Rexhep, Shaban dhe Ramazan, ku njerëzit duhet të japin kontributin e tyre të mirë për solidarizim me njerëzit në nevojë. Falënderoj të gjithë emigrantët e Drishtit dhe të Postribës, të cilët u treguan të gatshëm në ndihmesën e kësaj familje, ku varfëria është ulur këmbëkryq në këtë vend, si dhe z. Zamir Milani, i cili po bën koordinimin e kontributeve të emigrantëve dhe zbatimin e restaurimit të kësaj banese.

Restaurimi i banesës parashikohet të përfundojë me fillimin e muajit të begatë të Ramazanit.



TURQISHTJA DHE SHQIPJA KANË RRETH 5.000 FJALË TË PËRBASHKËTA



Në qytetin e Shkodrës është zhvilluar konferenca “Turqishtja, gjuha e tolerancës në Ballkan”, që kishte në fokus fjalët e përbashkëta, me pjesëmarrjen e zyrtarëve të institucioneve turke dhe shqiptare dhe studiuesve nga vende të ndryshme të rajonit.

Në këtë konferencë morën pjesë 6 kumtues nga 5 shtete: Turqia, Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

Kumtuesit pjesëmarrës në konferencë ishin Kryetari i Institutit të Gjuhës Turke, Prof. dr. Güler Gülsevin, Prof. Lindita Khanari (Latifi) nga Shqipëria, Leyla Şerif Emin nga Maqedonia e Veriut, Prof. dr. Irfan Morina dhe Prof. as.dr. Elsev Birina Lopar nga Kosova si dhe Prof. dr. Marija Dindic nga Serbia.

Në konferencën që krijoi jehonë në Shkodër dhe në të gjithë Ballkanin, morën pjesë ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë Murat Ahmet Yörük, Sekretarja e Përgjithshme e Prefekturës të Qarkut Shkodër Felek Kasemi, Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed Sytari, Rektori i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” Prof. dr. Adem Bekteshi, përfaqësues të institucioneve mediatike, akademike, drejtues të shkollave, studentë dhe qytetarë të Shkodrës.

Në përshëndetjen drejtuar pjesëmarrësve dhe të ftuarve gjatë fjalës së hapjes drejtori i institutit turk “Yunus Emre”, Shkodër, Zafer Kırıncı tha se me shtrirjen osmane në rajon mijëra fjalë turke hynë në gjuhët e Ballkanit: “Shteti Osman filloi një zhvillim serioz dhe me aktivitete kulturore në rajon në strukturën e tij shoqërore, rendin shtetëror, edukimin dhe filozofinë e pasur të artit. Bashkëjetesa në më

shumë se 500 vite ka prekur çdo fazë të jetës dhe kultura është transferuar përmes koncepteve dhe termave në të gjitha fushat. Efekti i turqishtes në gjuhët ballkanike nuk është i kufizuar, vetëm në shkëmbimin e fjalëve, proverbat dhe idiomat turke përdoren në rajonin e Ballkanit, identike ose me disa ndryshime tingujsh, ose duke u përkthyer në gjuhën përkatëse. Përveç kësaj, ne përballemi me fjalë turke në poezi, këngë popullore, madje edhe në këngë popullore që të rinjtë nuk i lënë sot nga gjuha e tyre. Ashtu siç njerëzit e Ballkanit, kur shkojnë në Turqi për pushime apo synime të ndryshme dëgjojnë fjalë që ata i përdorin në përditshmërinë e tyre, gjithashtu edhe ne turqit që jetojmë në Ballkan na bie shpesh të takohemi me fjalë turke që përdoren këtu”.

Ambasadori i Turqisë në Shqipëri, Murat Ahmet Yörük në fjalën e tij përshëndetëse tha se kjo konferencë mbart një kuptim të madh sa i përket lidhjeve gjuhësore dhe kulturore.

“Ne ndajmë elemente të përbashkëta gjuhësore me vendin tonë vëlla Shqipërinë, ku posedojmë një histori të gjatë dhe një prejardhje të gjerë kulturore. Turqishtja dhe shqipja përbajnë më shumë se katër mijë fjalë, shprehje dhe idioma të përbashkëta. Mund të mendohet se kjo shifër e fjalëve të përbashkëta dyfishohet nëse marrim parasysh vëllëzërit tanë shqiptarë që jetojnë në një pjesë të madhe të gjeografisë së Ballkanit. Turqishtja ka një histori rreth pesëshekullorë në këtë gjeografi”, tha ambasadori turk.

Ambasadori Yörük theksoi se turqishtja ka lënë gjurmë të thella në Ballkan dhe është pasqyruar në botën

MBRETËRIA E ARABISË SAUDITE PEZULLON VIZITAT PËR UMRE NË MEKË DHE MEDINE

Arabia Saudite me anë të një vendimi do të ndalojë vizitën në dy vendet e shenja, Mekë dhe Medine. Ky vendim shikohet si një masë për të evituar rrezikun e infektimit të qytetarëve me koronavirus.



Pas këtij vendimi besimtarët myslimanë nuk do mund të bëjnë ritin e Umre-s në këtë periudhë. Bile edhe ata që kanë marrë kohët e fundit viza për umre, nuk do të lejohen të hynë në Mbretërinë e Arabisë Saudite, njofton Ministria e Haxhit dhe Umres.

Për sa i përket ritit të Haxhit, i cili do të zhvillohet nga fundi i korrikut 2020 nuk është marrë akoma vendim.

Arabia Saudite ka ndaluar të gjithë udhëtarët që vinin nga vendet e prekura. Kujtojmë që deri tani, Arabia Saudite nuk ka raste të konfirmuara me koronavirus.

(www.radiojehona.al)

e mendimit në rajon. “Një përbërës të rëndësishëm në lidhjen tonë të fortë ende sot me popujt e Ballkanit e krijon edhe prania e fjalëve tona të përbashkëta. Me vëllëzërit tanë shqiptarë nuk kemi të përbashkëta vetëm elementët gjuhësore, ne gjithashtu ndajmë edhe kulturën e tolerancës me ta”, u shpreh më tej ambasadori turk.

Konferenca e ndjekur me shumë interes nga të ftuarit, përfundoi me dorëzimin e plaketave për kumtuesit, dhënë nga drejtori i institutit turk “Yunus Emre”.

Përgatiti për TRT Shqip,
Arben HALLUNI

(www.trt.net.tr)

RRËFIM - LABIRINTHE PERSONALITETI: E FORTË, EMPATIKE, MIRËKUPTUESE

*(Një intervistë në lidhje me gratë shqiptare në sferën publike)***Nga Alice Taylor**

Nada Dosti është një aktiviste, gazetare, editore, nënë dhe gjuhëtare. Ajo ka mbaruar për përkthim-interpretim në Universitetin e Tiranës dhe Gazetari në Ankara. Mund të flasë 5 gjuhë: anglisht, italisht, turqisht, maqedonisht dhe arabisht.

Ajo është muslimane me hixhab dhe është përqëndruar në punën e saj për të promovuar tolerancën dhe diversitetin si dhe luftimin e islamofobisë e forma të tjera të diskriminimit. Pavarsisht se jeton në Ankara, ajo udhëton shpesh Turqi-Shqipëri.

Më trego për veten tënde sikur të ishim takuar për herë të parë...

Unë jam Nada Dosti, nga Durrësi dhe jetoj në Ankara, Turqi, për më shumë se shtatë vjet tashmë. Kam punuar si gazetare e pavarur për rreth 10 vjet dhe aktualisht jam duke punuar si redaktore (freelance) për një institut kërkimor (TUBITAK).

Në vitin 2014 së bashku me disa mikeshatë mija aktiviste, themelova Muslimania.al e cila është një webfaqe me qëllimin për t'u dhënë zë grave muslimane shqiptare, duke adresuar racizmin anti-musliman dhe gjuhën e urrejtjes, duke promovuar diversitetin dhe duke sjellë histori sukses të grave në fusha të ndryshme. Muslimania.al i jep mundësinë komunitetit tonë të flasë (përmes seksionit "Zëri juaj") dhe të ngrejë zërin kundër padrejtësive shoqërore, në lidhje me çështje të ndryshme që shqetësojnë komunitetin tonë dhe shoqërinë në përgjithësi.

Temat për të cilat unë zakonisht shkruaj, përfshijnë çështjet gjinore, islamofobinë dhe çështje të tjera që shqetësojnë gratë myslimane. Gjithashtu shkruaj për portale dhe revista të ndryshme.

Unë jam nënë e një djalit 6-vjeçar gjysëm durrsak gjysëm tropojan që flet shqip, turqisht dhe anglisht, e që më është bashkuar në një numër aktiviteteve në të cilat kam marrë pjesë që kur ka lindur.

Cilat janë sfidat më të mëdha me të cilat përballeni dhe kenit përballur në të kaluarën?

Mësova mbi padrejtësinë në mënyrën

më të rëndë të mundshme. Ju ftoj të të imagjinoni një zonjushë 14-vjeçare, me një karakter të fortë, të pjekur dhe me një ide të qartë për identitetin e saj. Një grua e re muslimane që kishte ëndërr të studioje në një shkollë fetare, kështu që ajo të mund të mësonte me shumë rreth fesë së saj, dhe dëshironte të tregonte identitetin e saj duke zgjedhur të vishte hixhabin. Imagjinoni tani se si ëndrra e saj iu mohua nga njerëzit që i donte më së shumti: familja e saj.

Pas një beteje rraskapitëse, ajo arriti të korrë sukses, megjithatë, jeta nuk ishte aq e lehtë. Ajo e provoi mbi kurrizit e saj se çfarë do të thotë të mos pranohesh nga shoqëri vetëm për shkak të identitetit tënd. Ajo u përball me ngacmime nga njerëzit në rrugë, u përball me komente diskriminuese, abuzim verbal, komente pas shpinës, duke u dëbuar nga universiteti i qytetit (i Durrësit) dhe u detyrua të transferohej në Tiranë për të studiuar. U gjykua nga shokët e klasës dhe profesorët, duke e pyetur "a flet shqip?"; u refuzua nga shumë intervista pune me justifikimin "paraqitja juaj nuk është e përshtatshme për këtë punë"; jetonte dhe sillej duke qenë nën presion gjatë gjithë kohës duke u mundur të "sillesh në mënyrë të përsosur" sepse çdo gjë që do të vepronte ose thoshte, do të përdorej kundër fesë suaj – dhe jo kundër jush – "gjykatë".

Si i tejkalove të gjitha këto peripeci?

Ashtu siç vepron në të gjithë njerëzit e fortë: duke mos hequr dorë kurrë. Kam mësuar si të kundërpërgjigjem, si të kërkoj të drejtat e mia dhe të luftoj padrejtësitë. Kam mësuar si të tërhiqem për pak, të marr pak kohë për veten duke pushuar, dhe të përpiqem përsëri.

Si e sheh një shoqëri të përsosur?

Në fakt, nuk e kam menduar ndonjëherë, sepse duket si një nocion tepër idealist dhe nuk besoj se ekziston një "shoqëri e përsosur". Megjithatë, të studiuarit për një semestër në Maqedoni, udhëtimet e mia në të gjitha vendet e Ballkanit dhe disa vende në Evropë, Azi dhe Lindjen e Mesme, si dhe jetesa në Turqi, më ka ndihmuar të mësoj shumë për kulturat dhe njerëzit nga e gjithë bota. Jam e sigurt për një gjë: ajo që dua më shumë është multikulturalizmi

dhe diversiteti. Pra, hipotetikiisht, një "shoqëri të përsosur" do e përfytyroja si një shoqëri që është themeluar mbi bashkëjetesën midis multikulturalizmit dhe diversitetit duke respektuar të drejtat e njeri-tjetrit.

Tregomë për të qenurit një grua shqiptare në 2020?

Të jesh grua shqiptare në vitin 2020 do të thotë të përballësh (ende) me shumë luftëra. Femicidi (vrasja e grave) është ende një tragjedi e madhe e shoqërisë. Gratë shqiptare ende duhet të përballen me shumë pengesa si shovinizmi mashkullor dhe patriarkalizmi. Ato luftojnë për çdo ditë me mijëra beteja dhe po përpiqen të bëjnë më të mirën e mundshme për të vazhduar përpara dhe për t'u ngritur lart. Fatkeqësisht, si gra, nuk kanë mbështetjen e nevojshme nga gratë e tjera, duke filluar nga nënat e tyre që i rrisin, të cilat u mësojnë si të mbyllin gojën dhe të qëndrojnë heshtur, nga vjehrra, nga kolegët, miqtë etj. Gratë shqiptare e ndjejnë mungesën e rol-modeleve dhe mentoreve të cilat do kujdesen që t'i udhëzojnë dhe ndihmojnë të mbajnë kokat e tyre sa më lart.

Por gjendja nuk është e pashpresë. Unë besoj në të vërtetë se ka shumë përjashtime, dhe ky projekt (52 Gra Shqiptare) është një përpjekje e mrekullueshme për ta vërtetuar këtë. Ka shumë gra atje që përpiqen të japin maksimumin për të arritur sukses dhe për t'i treguar botës dhe veçanërisht vajzave të reja se mund t'ja dalin!

Cila është plani yt pas 5 vitesh?

Gjatë vizitave të mia kohëve të fundit në Shqipëri, kam qenë e ftuar në raste të ndryshme për të folur me vajzat në shkollat e mesme dhe universitetet. Më lëndoi aq shumë fakti që lexova aq shumë mungesë shprehe, vajza të reja pa ëndrra dhe pa plane për të ardhmen në sytë e tyre. Vajza kaq të demoralizuara dhe që kanë nevojë për rol-modele, frymëzim dhe motivim. Kështu që, në pesë vitet e ardhshme do të dëshiroja të gjeja mënyrën e duhur për të arritur qëllimin tim për të frymëzuar vajzat e reja në Shqipëri. Njëkohësisht do përpiqem të përqëndrohem më shumë në objektivat e mia sa i përket karrierës. Ende nuk kam vendosur nëse do të

filloj një doktoraturë në fushën time të studimeve apo të përqëndrohem më shumë në aktivizmin e mësimdhënies jo-formale.

Por një gjë për të cilën jam e sigurt, është fakti që nuk e shoh veten në fushën akademike. Pasi kam investuar kaq shumë energji dhe kohë për të fituar përvojë dhe njohuri se si të trajtoj dhe të frymëzoj të tjerë në mënyrën më të mirë, tashmë mendoj se është koha të jap nga ajo që kam mbledhur gjatë gjithë këtyre viteve në aktivizim. Plani im 5-vjeçar do të jetë një përpjekje për të krijuar një ekuilibër midis jetës sime personale-familjare, karrierës dhe aktivizmit që është një betejë e vazhdueshme midis marrjes dhe dhënies.

A je, apo a ke qenë ndonjëherë e frikësuar për shkak të punës tënde?

Të punosh për media të ndryshme si gazetarë e pavarur ndonjëherë mund të jetë e rrezikshme për sigurinë tënde, por edhe për karrierën. Asnjëherë nuk mund të jesh 100 përqind e sigurt për axhendat që fshehin pas mediat me të cilat je lidhur. Andaj nuk është e thjeshtë të jesh një gazetare e pavarur.

Kur flisni kundër padrejtësisë sociale duhet ta bëni këtë në një mënyrë të zgjuar. Sigurisht që kam marrë kërcënime për shkatërrimin tim, të familjes sime dhe karrierës. Normal që është shumë e pakëndshme të qenit nën presion gjatë gjithë kohës, veçanërisht kur nuk keni mbështetjen e të afërmeve dhe miqve që thjesht mendojnë se duhet të hiqni dorë.

Pasi linda djalin tim, të gjithë bënë supozime të tilla si "Ti akoma vazhdon me këtë punë?" ose "Tashmë je nënë, a nuk mendon për djalin tënd, nëse nuk kujdesesh për veten të paktën mendo për të dhe familjen tënde".

Shumë nga të afërmit dhe miqtë e mi, dhe gjithashtu disa OJQ, në një moment të caktuar të jetës sime nuk donin të kishin lidhje me mua dhe u përpoqën të më shmangnin.

Një herë, kur udhëtova për në Palestinë për të shkruar një histori udhëtimi, më ndaluan për katër orë gjatë nisjes dhe gjithashtu në kthim, një marrje në pyetje e vërtetë për çdo detaj të jetës dhe punës sime. Unë e quaj këtë "fatin tim kryqëzues", që do të thotë se je në shenjës të gjatë gjithë kohës, sepse je nga Shqipëria (anëtare e Organizatës së Kooperimit Islam) jeton në Turqi, muslimane, me hixhab dhe gazetare. Kjo më shndërron

në një objektiv shumë të lehtë sidomos në aeroporte dhe veçanërisht në "Ben Gurion" (Aeroporti në Tel Aviv). Dhe sigurisht, nuk i tregova askujt se po udhëtoja për në Palestinë, përveç burrit tim, vetëm e vetëm për të shmangur komentet e rastit të tipit: "A po shkoni në një zonë lufte, a je e çmendur, a dëshiron të vritesh atje?"

Së dyti, më mërzisnin shumë ato situata kur njerëzit që më gjykojnë duke patur parasysh atë stereotipin e gazetarit që edhe gjatë një bisede normale për një temë delikate mendojnë se do ta përdor në shkrimin tim. Ata thonë "të lutem mos shkruaj gjë për këtë që po flasim", "aman se mos më përmendësh në media" ose "se mos shkruan ndonjë artikull për këtë."

Gazetarët nuk janë të gjithë të tillë!
Çfarë këshille do t'i jepje vetes tënde të re?

"Jeta është tepër e shkurtër për të mësuar gjermanishten", thonë! Më mirë nisja që tani!

Nëse jo gjermanisht, të lutem mësoni dy gjuhë të tjera sepse kur të arrish në moshën time, pesë gjuhë të huaja nuk do të jenë të mjaftueshme për të përmbushur vetë-pritshmëritë e tua.

Të lutemi lexo më shumë libra dhe udhëto më shumë! Tani, sa më parë! Mos prit derisa të kesh shumë më shumë angazhime dhe përgjegjësi.

Dhe së fundi, a e mbani mend atë ëndërrën tënde për të shpëtuar botën? Anulloje misionin! Po e përsëris: Anulloje misionin! Marrje!

Më mirë fillo të shpëtosh veten, komunitetin tënd dhe më pas vendin tënd. Sepse shpëtimi i botës është një mision pothuajse i pamundur, njëjtë sa misioni i mësipërm!

Cila do të ishte këshilla juaj drejtuar grave të tjera të cilat e gjejnë veten në fjalët e tua?

E di që nuk është e lehtë, e dashur, por ka për t'ja vlejtur një ditë! Cilado qofshin mundimet tuaja, mos ndalo së luftuari për të drejtat tuaja. Mos heshtni kundër padrejtësisë, por kur të ngrini zërin, bëjeni atë në një mënyrë të zgjuar dhe me mjetet e duhura. Mbështetni gratë e tjera në vend që t'i hidhni poshtë ato.

Përshkruaje veten në tre fjalë

Kjo qenka dhe pyetja më e vështirë, megjithatë do përpiqem të jem sa më e sinqertë: E fortë, empatike dhe mirëkuptuese!

(www.tesheshi.com)

SHBA MIRATON KËRKESËN E XHAMIVE PËR TË TRANSMETUAR EZANIN PËRMES ALTOPARLANTËVE

Qyteti Paterson, i shtetit të New Jersey, në SHBA, ka mbështetur një urdhëresë, që lejon transmetimin e ezanit përmes altoparlantëve.

Sipas masës së re, që ende duhet të kalojë në dy seanca dëgjimi publike përpara se të zbatohet, ezani do të përjashtohet nga urdhrat e kontrollit të zhurmës së qytetit dhe do të lejohet të transmetohet jashtë, çdo ditë nga ora 06:00 AM deri në orën 10:00 PM.



Rezoluta u miratua nga anëtarët e këshillit të martën me një votim me 7 vota pro, asnjë kundër dhe abstenime.

"Ne i duartrokasim zyrtarët e Patersonit për ndërmarrjen e këtij hapi të admirueshëm drejt përfshirjes dhe i inkurajojmë ata të kalojnë dekretin e propozuar," - tha Salaedin Maksut, drejtori ekzekutiv i Këshillit për Marrëdhëniet Amerikano-Islamike (CAIR), dega New Jersey.

Gjithashtu Salaedin Maksut shtoi në fjalimin e tij duke thënë: "Mentaliteti i hapur ndaj ligjeve të tilla është një demonstrim konkret i respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë midis banorëve të komuniteteve tona të çmuara dhe të larmishme."

Për dijeni, qyteti i Patersonit në shtetin e New Jersey në SHBA, ka rreth 30,000 banorë myslimanë, së bashku me më shumë se 15 xhami të shpërndara në të gjithë zonën.

(www.dailytrust.com)

Përktheu nga anglishtja:

Ervil Kuçi

العدد الاول
السنة الثالثة

١١ كانون الثاني ١٩٤٢
٢٢ ذي الحجة ١٣٦٠

هنا القدس

**ISHTE VITI 1942 NË SIRI!
SIRIANËT DUKE NDIHMUAR GREKËT ME USHQIM DHE VESHMBATHJE,
PASI QË ATA ISHIN ARRATISUR NGA GREQIA PËR SHKAK TË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE.**



توزيع الاطعمة والثياب في سوريا على اللاجئين من بلاد اليونان

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org